

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
MINISTRIA E DREJTËSISË
Byroja e Përfaqësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut
Në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut

RAPORT VJETOR
RRETH PUNËS SË BYROSË SË PËRFAQËSIMIT
TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
NË GJYKATËN EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT PËR VITIN 2022

2023, SHKUP

1.HYRJE

Byroja e Përfaqësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ/Gjykata) është themeluar në fillim të vitit 2015 në pajtim me Ligjin për përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“Gazeta Zyrtare” nr. 67/2009, 43/2014 dhe 64/2018), si person juridik më vete në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Përveç këtij ligji, kompetencat e Byrosë për përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në GJEDNJ, janë përcaktuar edhe me Ligjin për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“Gazeta Zyrtare” nr. 67/2009 dhe 43/2014).

Ligji për përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë në KEDNJ, ia ngarkon Byrosë rolin e përfaqësimit të interesave shtetërore para GJEDNJ-së, në pajtim me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ/Konventa) dhe Protokollet e saj. Duke pasur parasysh natyrën dhe shtrirjen e kompetencave të besuara, Byroja për Përfaqësim të Republikës së Maqedonisë së Veriut *de facto* është organ i specializuar për përfaqësimin e të gjitha organeve shtetërore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në procedurat para GJEDNJ-së kundër shtetit.

Përveç kompetencave në fushën e përfaqësimit në GJEDNJ, Byrosë për Përfaqësim pranë GJEDNJ-së i janë besuar edhe kompetenca në fushën e koordinimit të ekzekutimit të aktgjykimeve dhe vendimeve të GJEDNJ-së dhe komunikimit me Komitetin e Ministrave për qëllime të mbikëqyrjes, që ky organ i Këshillit të Evropës mbikëqyr ekzekutimin e aktgjykimeve dhe vendimeve të GJEDNJ-së. Ndër të tjera, Byroja është mbështetja profesionale dhe administrative-teknike e Komisionit Ndërmnistror për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së.

2. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI GJENDJEN NË GJEDNJ GJATË VITIT 2022

GJEDNJ ishte jashtëzakonisht aktive gjatë vitit 2022, duke vendosur për 39.570 kërkesa të dorëzuara.

Numri i aplikimeve të vendosura nga Gjykata gjatë vitit 2022 arriti në 4168, që tregon një rritje prej 33% në vitin 2022, krahasuar me vitin 2021 kur u vendos për 3131 aplikime. Komiteti prej tre

gjqtarësh¹ vendosi për 3,554 aplikime, dhe formacionet e përbëra nga një gjyqtar individual trajtuan 30,600 aplikime. Një numër madh i kërkesave u konsoliduan, duke rezultuar në 1,163 aktgjykime (për 4,168 aplikime), krahasuar me vitin 2021 kur u bënë 1,105 aktgjykime (për 3,131 aplikime).

Sa i përket numrit të aplikimeve të dorëzuara gjatë vitit 2022, ky numër ka arritur në 74.650 aplikime, që është për 6% më i lartë se vitin e kaluar, kur numri ishte 70.150. Numri i aplikimeve të dorëzuara të caktuara në një këshill është rritur me 15%, që nga 1 janari 2022 (35,100 aplikime). Numri i aplikimeve të dorëzuara në komision gjithashtu u rrit me 9% (34,800 aplikime). Megjithatë, ka një rënie të numrit të aplikimeve të dorëzuara të caktuara për një gjyqtar individual, i cili ka rënë për 38% krahasuar me vitin paraprak (4750 aplikime).

Në fund të vitit kishte 69,900 aplikime në pritje për në këshill (përfshirë Këshillin e Madh Gjyqësor) ose komitetin që ishin në pritje të zgjidhjes, dhe 4,750 aplikime te gjyqtari individual.²

Pesë vendet të cilave u referohen shumica e rasteve në procedurat para GJEDNJ-së, mbetën të njëjta me vitin e kaluar, por Turqia, me rreth 20,100 aplikime, u bë vendi me numrin më të madh të rasteve që nga 1 gushti 2022; e ndjekur nga Federata Ruse, me rreth 16750 aplikime; Ukraina me 10.400 aplikime; Rumania me 4800 aplikime dhe Italia me rreth 3550 aplikime.

Pothuajse 10,200 nga aplikimet e paraqitura kishin të bënin me një mosmarrëveshje midis shteteve të ndryshme anëtare. Bëhet fjalë për raste komplekse që kërkojnë përpjekje të veçanta, veçanërisht për sa i përket personelit, dhe të cilat kanë justifikuar krijimin e një Departamenti të veçantë brenda Gjykatës për të vendosur për to.

Duke marrë parasysh risinë që Gjykata futi në vitin 2021 në politikën e saj për t'i dhënë përparësi çështjeve më të rëndësishme, serioze dhe urgjente, për të përshpejtuar procedurën për to, nga numri i përgjithshëm i aplikimeve të paraqitura gjatë vitit 2022, rreth 23,850 u identifikuan si "lëndë prioritare". Shumë prej tyre, sipas praktikës gjyqësore, janë raste të përsëritura ku parimet ligjore të zbatueshme janë tashmë të përcaktuara mirë. Duke përcaktuar se një numër i

¹Lëndët në GJEDNJ zgjidhen në katër lloje të ndryshme të formacioneve gjyqësore. Në pajtim të nenit 26 (1) të KEDNJ-së: "Për të shqyrtuar një lëndë përpara saj, Gjykata mblidhet në formacion me një gjyqtar individual, në komitete prej tre gjyqtarësh, në këshilla me shtatë gjyqtarë dhe në një dhomë të madhe prej shtatëmbëdhjetë gjyqtarësh". Gjyqtarët individualë përcaktojnë pranueshmërinë e parashtrësive individuale, të cilat më së shpeshti përfshijnë raste qartësisht të pabazuara. Ky sistem është krijuar për të ndihmuar në reduktimin e akumulimit të një numri të madh lëndësh. Të përbërë nga tre gjyqtarë, komitetet vendosin për pranueshmërinë e lëndëve, si dhe për bazueshmërinë kur lënda ka të bëjë me një çështje që mbulohet nga praktika gjyqësore e mirëpërcaktuar (vendimi duhet të jetë unanim). Të përbërë nga shtatë gjyqtarë, këshillat kryesisht vendosin për pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e rasteve që ngrenë çështje që shpesh nuk janë vendosur (vendimi mund të merret me shumicë votash). Çdo Këshill përfshin Kryetarin e Këshillit dhe një "gjyqtar nacional" (një gjyqtar me shtetësinë e vendit kundër të cilit është bërë aplikimi). I përbërë nga 17 gjyqtarë, Këshilli i Madh shqyrton një numër të vogël e të përzgjedhur lëndësh të referuara ose mbi të cilat Këshilli i ka lënë juridiksionin, zakonisht kur lënda përfshin një çështje të rëndësishme ose të re. Këshilli i Madh Gjyqësor gjithmonë përfshin Kryetarin dhe Zëvendëskryetarin e Gjykatës, kryetarët e departamenteve dhe gjyqtarin nacional.

²Krahasuar me 2021 – 62,450 aplikime në pritje përpara një këshilli ose komiteti, dhe 7,700 aplikime para një gjyqtari individual.

madh i lëndëve të tilla të rëndësishme nuk hyjnë në kategorinë e "lëndëve prioritare" sipas kategorizimit ekzistues të Gjykatës, në vitin 2021 ajo prezantoi një kategori të re të "rasteve me ndikim" në të cilat, sipas kritereve të përcaktuara saktësisht, i vendosi lëndët që ngrenë çështje të rëndësishme dhe kanë ndikimin më të madh në njohjen e mangësive në sistemet nacionale, për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Kështu, më 1 janar 2022, nga 21.486 aplikime në pritje të Kategorisë IV, 528 u identifikuan si "lëndë me ndikim". Një vit më vonë, 429 nga 26,527 aplikime të Kategorisë IV janë identifikuar si të tilla. Në 78% të këtyre rasteve, qeveritë e shteteve anëtare të thirrura për llogari janë njoftuar tashmë për aplikime të tilla. Gjatë vitit 2022 janë hetuar 551 "raste ndikimi": 187 prej këtyre kërkesave kanë rezultuar me aktgjykime; 41 prej tyre ishin të papranueshme ose u hoqën nga lista e lëndëve, dhe 323 iu dorëzuan qeverive të thirrura për llogari, pra qeverive kundër të cilave u paraqitën aplikimet.

Ndër "lëndët me ndikim" më të rëndësishëm, GJEDNJ-ja veçon në raportin e saj të vitit 2022: aktgjykimet për ngacmim seksual në vendin e punës (*C.v. Rumania*, A. Nr. 47358/20); pamundësia e qasjes ke karrocë invaliditeti në objektet publike (*Arnar Helgi Lárusson v. Island*, A. No. 23077/19); liria e shprehjes së gjyqtareve (*Żurek v. Poland*, A. No. 39650/18); lëshimet në votim nga një pakicë kombëtare (*Bakirdzi and EC v. Hungaria*, A. No. 49636/14, 65678/14) dhe moszbatimi i masave të shpejta dhe gjithëpërfshirëse për desegregimin e nxënësve romë në shkollën fillore (*X and Others v. Albania*, A. Nr.73548/17, 45521/19)³.

Gjykata dëshmoi ndryshime të tjera të rëndësishme gjatë vitit 2022. Protokollin nr. 15 i KEDNJ-së i cili hyri në fuqi më 1 gusht 2021 parashikonte një afat të ri për dorëzimin e aplikimit në Gjykatë i cili u shkurtua nga gjashtë në katër muaj për rastet në të cilat vendimi i formës së prerë në vend ishte marrë më ose pas datës 1 shkurt 2022, dhe filloi të zbatohet nga 1 shkurt 2022.

Gjatë vitit 2022, 4 kërkesa për opinione këshillimore të paraqitura nga gjykatat më të larta vendase të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës (Lituania, Armenia, Franca dhe Finlanda) u pranuan si një mundësi që parashikonte Protokollin nr. 16 i Konventës, dhe Gjykata vendosi për tre prej tyre gjatë vitit 2022. Duke pasur parasysh se në vitin 2023 bëhen pesë vjet nga hyrja në fuqi e Protokollit nr. 16⁴Gjykata i konsideroi këto zhvillime si një shenjë inkurajuese për mundësinë e dhënies së opinioneve këshillimore për shtetet anëtare nga gjykatat e tyre më të larta.

³Me aktgjykim të datës 13.12.2022, në rastin *Elmazova dhe të tjerë kundër shtetit*, Gjykata konstatoi shkelje identike në kuadrin e ankesave të ngjashme, si në lëndën kundër Shqipërisë.

⁴Republika e Maqedonisë së Veriut nuk është ndër vendet që e kanë ratifikuar Protokollin.

Më 18 tetor 2022, Gjykata publikoi një version të jashtëm të platformës së saj të shkëmbimit të njohurive, i cili tani është i disponueshëm publikisht në faqen e saj të internetit⁵. Kjo platformë është krijuar për të forcuar më tej rolin ndihmës të Konventës Evropiane dhe Gjykatës dhe për të shpjeguar jurisprudencën e saj në mënyrën më transparente dhe tematike të mundshme, pasi synon të përmirësojë integrimin e jurisprudencës së Gjykatës në sistemet ligjore nacionale, duke nënvizuar faktin se përgjegjësia kryesore për mbrojtjen e të drejtave të Konventës i takon autoriteteve nacionale.

Gjatë vitit 2022, shumica e kërkesave në GJEDNJ, janë zgjidhur me vendim. 113 aplikime janë përcaktuar si të papranueshme, ose janë hequr nga lista e lëndëve në Gjykatë nga këshillat, dhe 4703 vendime të tilla janë marrë nga komitetet. Gjithashtu, gjyqtarë individualë konstatuan se ishin të papranueshme ose i hoqën nga lista e lëndëve në Gjykatë rreth 30.585 aplikime.⁶ Numri i vendimeve për papranueshmëri dhe për heqjen e aplikimeve nga lista e lëndëve në Gjykatë u rrit me 7%, nga 32,962 në 2021, në 35,402 aplikime në vitin 2022.

Në varësi të formacioneve gjyqësore, në vitin 2022 janë miratuar 358 aktgjykime nga këshillat, 796 nga komitetet, ndërsa 9 aktgjykime janë miratuar nga Këshilli i Madh Gjyqësor.⁷

Vendin e shkeljeve më të konstatuara në vitin 2022 e zë neni 5 (e drejta për liri dhe siguri), për të cilin Gjykata konstatoi shkelje në gjithsej 407 aplikime. Kategoria e dytë thelbësore e shkeljeve të konstatuara të KEDNJ-së, është ajo sipas nenit 3 (ndalimi i torturës dhe trajtimit ose dënimit çnjerëzor ose poshtëruës) me një numër total prej 403 aplikimesh. Në vend të tretë konstatohen shkelje të nenit 6 (e drejta për gjykim të drejtë) në gjithsej 346 aplikime.

Me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe përshpejtimit të procedurës në GJEDNJ, pas futjes së të aq. *WECL* procedura (*well established case law*/procedura për lëndët që ngrenë çështje që janë pjesë e praktikës gjyqësore mirë të vendosur së GJEDNJ-së) në vitin 2017, gjatë të njëjtit vit Gjykata aplikoi edhe të ashtuquajturat *IMSI* procedura (*procedure of immediate simplified communication of cases*/procedurë për komunikim të shpejtë të thjeshtuar të lëndëve). Futja e këtyre procedurave nga GJEDNJ, presupozon rritje të ngarkesës së punës për Byronë e Përfaqësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në GJEDNJ, por gjithashtu rrit presionin për funksionimin e institucioneve në shtet në përputhje me standardet e përcaktuara në praktika gjyqësore të GJEDNJ-së.

⁵<https://ks.echr.coe.int/en/web/echr-ks/>

⁶Krahasuar me 2021 - 139 aplikime janë përcaktuar si të papranueshme ose janë hequr nga lista e lëndëve në Gjykatë nga këshillat, dhe rreth 4856 vendime të tilla janë marrë nga komitetet, ndërsa gjyqtarë individualë kanë konstatuar se janë të papranueshme ose janë hequr nga lista e lëndëve në Gjykatë rreth 27.966 aplikime.

⁷Krahasuar me 2021 - 416 aktgjykime nga këshillat, 677 nga komitetet dhe 12 aktgjykime nga Këshilli i Madh Gjyqësor.

Me futjen e *IMSI* procedurës, puna e Byrosë për Përfaqësim në GJEDNJ, u rrit në vëllim dhe shkallë të kompleksitetit. Kjo procedurë, ndryshe nga procedura standarde, e cila supozonte se GJEDNJ ishte duke përgatitur tashmë gjendjen faktike (*statement of facts*) sipas lëndës, por edhe pjesës së legjislacionit përkatës të brendshëm (*relevant domestic law*) sipas të cilit shteti vetëm pronocohej, tani barrën e përgatitjes së këtyre dy pjesëve e bartë shteti, gjegjësisht të njëjtën e përgati Byroja për Përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në GJEDNJ. Përveç kësaj, kjo presupozon mundësinë që në rast se Qeveria nuk i mohon disa pretendime të aplikantit, GJEDNJ-ja, do t'i marrë parasysh ato si supozime faktike mbi të cilat mund të bazojë vendimin e vet. Këtyre ndryshimeve në procedurën para GJEDNJ-së, duhet t'i shtohet fakti se Byroja e Përfaqësimit pranë GJEDNJ-së, punon sipas afateve ekskluzive që i përcakton GJEDNJ-ja, për çdo veprim procedural, si dhe fakti i ndryshimit të strukturës së lëndëve që i paraqiten shtetit si përgjigje, të cilat ngrenë çështje shumë më komplekse, për shembull nga ato që u ngritën në rastet me pretendime për shkelje të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, të cilat për një periudhë të caktuar dhe më të gjatë përbënin shumicën e rasteve të lëndëve të dorëzuara shtetit për përgjigje.

Nga ana tjetër, klasifikimi i një lënde kundër shtetit si *WECL* një lëndë që ngre një çështje që është pjesë e praktikës së mirëfilltë gjyqësore, supozon se GJEDNJ ka vendosur tashmë për çështjet juridike të kontestuara që ajo ngre, por jo domosdoshmërisht në një lëndë kundër shtetit specifik, por është e mjaftueshme për çështjen e kontestuar GJEDNJ të ketë vendosur edhe në një lëndë kundër një shteti tjetër anëtar të Këshillit të Evropës. Kjo tregon për faktin se numri i lëndëve kundër shtetit që do të klasifikohen në këtë grup lëndësh dhe për të cilat vendos komiteti prej tre gjyqtarësh, sigurisht që do të rritet. Vendimet dhe aktgjykimet e marra nga komiteti prej tre gjyqtarësh marrin formë të prerë në ditën e miratimit të tyre, dhe në lidhje me to nuk lejohet kërkesa për shqyrtimin e lëndëve nga Këshilli i Madh Gjyqësor i GJEDNJ-së. Kjo tregon nevojën e zbatimit dhe respektimit konsekuent të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, nga të gjitha institucionet në sistemin e shtetit, dhe njohja e saj dhe mjetet bazë për hulumtimin e saj janë ngritur si pyetje të mëparshme.

Duke filluar nga 1 janari 2019, GJEDNJ vendosi të aplikojë një praktikë të re për të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, në një fazë të veçantë të proceseve në GJEDNJ (faza jokontestimore/*non-contentious phase*)⁸. Qëllimi i futjes së një faze të tillë, sipas Gjykatës, është thjeshtimi i procesit të zgjidhjes miqësore ndërmjet palëve në lëndët në GJEDNJ. Aplikimi i kësaj praktike ka vazhduar edhe gjatë vitit 2022.

⁸ <https://www.youtube.com/watch?v=yUcbKISuxiE&feature=youtu.be>

Praktika e re në thelb ndan fazën jokontestimore të procedurës (ose fazën e parë që zgjat 12 javë) nga faza e kontestuar (ose faza e dytë e procedurës e cila zhvillohet në 12 javët e ardhshme) që është në fakt faza e procedurës në të cilat shkëmbehen vërejtjet dhe gjykimet ndërmjet palëve, në rast të dështimit të arritjes së marrëveshjes për zgjidhjen miqësore ndërmjet palëve.

Mirëpo, sipas praktikës së re, Regjistri i GJEDNJ-së nuk do të bëjë propozim të veçantë për zgjidhje miqësore në çdo lëndë, pra nuk do të bëjë propozim në rastet që i referohen çështjeve të reja që Gjykata nuk i ka vlerësuar asnjëherë, apo rasteve për të cilat, për ndonjë arsye specifike, nuk do të ishte e përshtatshme të propozohej një zgjidhje miqësore. Në lëndët që janë dorëzuar për përgjigje sipas praktikës së re dhe në të cilat, për arsye të ndryshme, Regjistri i GJEDNJ-së nuk do të dalë me propozimin e vet dhe specifik me kushte të përcaktuara qartë dhe saktë për marrëveshje, sipas të cilave palët në procedurë duhet të prononcohen, ato konsiderohen të thirrura në mënyrë dypalëshe për të negociuar kushtet e një marrëveshjeje eventuale. Megjithatë, Byroja për Përfaqësim në GJEDNJ, në parim, i propozon Qeverisë së Maqedonisë së Veriut një zgjidhje miqësore vetëm në rast të kushteve të qarta dhe precize për marrëveshje të propozuara nga GJEDNJ-ja.

3. REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT DHE GJEDNJ GJATË VITIT 2022


Numri i aplikimeve të dorëzuara në GJEDNJ kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut, duket se ka ruajtur të njëjtin trend në rritje si në vitin 2021, gjatë vitit 2022. Ngjashëm me vitet e mëparshme, gjatë vitit 2022, ky numër është mbi mesataren evropiane të matur sipas indeksit të aplikimeve të dorëzuara për 10 mijë banorë, i cili në nivel evropian gjatë vitit 2022 ishte 0.54. Në vitin 2022, sipas këtij indeksi, Republika e Maqedonisë së Veriut përfundoi në vendin e 7-të në familjen e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës me indeks 2.00. Indeksi i kërkesave të dorëzuara në GJEDNJ për 10 mijë banorë ndaj shtetit gjatë vitit 2021 ishte 1.90, në vitin 2020 ishte 1.32, në 2019 ishte 1.26, në 2018 ishte 1.47, në 2017 ishte 1.66, në vitin 2016 indeksi ishte 1.64, dhe ky indeks në vitin 2021 në shtet ishte në vendin e 7-të, në vitin 2020 ishte në vendin e 12-të, në vitin 2019 ishte në vendin e 11-të, në vitin 2018 ishte në vendin e 9-të, dhe në vitin 2017 dhe 2016 ishte në vendin e 11-të, ndër shtetet anëtare të Këshillit të Evropës.

Gjatë vitit 2022, GJEDNJ vendosi për gjithsej 314 kërkesa kundër Maqedonisë së Veriut (për dallim nga viti 2021, kur ky numër ishte 368).

Në vitin 2022, GJEDNJ shpalli gjithsej 302 kërkesa kundër shtetit të papranueshme ose të hequra nga lista e lëndëve të veta, për dallim nga viti i kaluar 2021 kur numri ishte 362. Edhe

pse, më së shpeshti për shkak të mospërmbushjes së disa supozimeve formale (si mos respektimi i afateve për dorëzimin e kërkesave, ose mospërdorimi i mjeteve ligjore vendase përpara dorëzimit të aplikimit), në këtë lloj aplikimesh që përfundojnë si të papranueshme, Gjykata është të penguar nga shqyrtimi i bazueshmërisë së të njëjtëve (shumica prej tyre pa iu dorëzuar shtetit për përgjigje, në rastin kur vendos një gjyqtar individual), nuk duhet të përjashtohet mundësia, që ata ende të zbulojnë shkelje të rënda të KEDNJ-së.

Gjatë vitit 2022, gjithsej 367 aplikime kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut janë paraqitur në formacione të ndryshme gjyqësore në GJEDNJ, që do të thotë një rënie në krahasim me vitin paraprak 2021 kur ky numër ishte 394, ndërsa në vitin 2020 kishte 275 aplikime.



Gjatë vitit 2022, në Byronë e Përfaqësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, janë dorëzuar gjithsej 24 aplikime. Shihni më shumë për aplikimet që janë dorëzuar për përgjigje në shtet gjatë vitit 2022 dhe për pretendimet për shkelje të KEDNJ-së të ngritura në to në [Aneksin nr.1](#).

Gjatë vitit, kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut janë miratuar gjithsej 6 aktgjykime për gjithsej 12 aplikime (duke pasur parasysh se për disa prej tyre Gjykata ka bashkuar procedurën),

dhe vetëm në 4 prej tyre është konstatuar shkelje e GJEDNJ-së (më shumë detaje rreth aktgjykimeve dhe vendimeve të GJEDNJ-së shih më poshtë).⁹

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut i ka paraqitur kërkesë shtetit për masë të përkohshme dhe pasi ka ftuar shtetin për tu prononcuar, Gjykata ka vendosur që të mos vendosë masë të përkohshme ndaj shtetit.

4. AKTGJYKIMET DHE VENDIMET E GJEDNJ KUNDËR REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Që kur vendi ka ratifikuar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut më 10 prill 1997, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka nxjerrë 191 aktgjykime dhe 526 vendime, për pranueshmëri dhe vendime për heqjen e aplikimeve nga lista e lëndëve para Gjykatës në rastet kundër Maqedonisë së Veriut. Nga numri i përgjithshëm i vendimeve kundër shtetit, 154 janë miratuar nga këshilli, 35 nga një komitet prej tre gjyqtarësh në të ashtuquajturat lëndë “përsëritëse” apo të ashtuquajturat lëndë *WECL* të praktikës gjyqësore të krijuar mirë dhe 2 nga Këshilli i Madh Gjyqësor. Gjatë vitit 2022 ndaj vendit tonë janë dhënë 6 aktgjykime¹⁰ dhe 15 vendime.

4.1. Shkeljet e konstatuara kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut

Nga numri i përgjithshëm i aktgjykimeve kundër shtetit, 123 aktgjykime i referohen nenit 6 të Konventës, *të drejtës për një gjykim të drejtë*, ku janë konstatuar shkelje në 116 lëndë. Një numër vendimesh në lidhje me nenin 6 i referohen të drejtës për një gjykim brenda një kohe të arsyeshme. Gjykata u shpreh se aplikantët duhet së pari të paraqesin një kërkesë për mbrojtjen e të drejtës për gjykim brenda një kohe të arsyeshme në Gjykatën e Lartë, e cila konsiderohet një mjet efektiv juridik, përpara se ta çojnë rastin e tyre para saj¹¹, edhe kur kompensimi i dhënë nga Gjykata e Lartë ishte i pamjaftueshëm, pra i vogël në krahasim me shumën që do të ishte dhënë nga GJEDNJ në rrethanat e rastit.¹²

⁹ *Mickovski*, aktgjykimi i datës 24 mars 2022; *AA dhe të tjerët*, aktgjykimi i datës 5 prill 2022; *Kostova dhe Apostolov* aktgjykimi i 5 prillit 2022; *Kostovski*, aktgjykimi i datës 7 qershor 2022; *Talevska dhe Tërçeska*, aktgjykimi i datës 28 qershor 2022; *Elmazova dhe të tjerët*, aktgjykimi i datës 13 dhjetor 2022.

¹⁰ *ibid.*

¹¹ *Axhi-Spirkoska dhe të tjerë*, vendimi i këshillit 3 nëntor 2011.

¹² *Petroviq*, aktgjykimi i datës 22 qershor 2017.

Shumë raste civile dhe administrative kanë ngritur pyetje në lidhje me paanshmërinë¹³, parimi i barazisë së armëve¹⁴, mungesa e sigurisë juridike dhe praktika konsistente gjyqësore¹⁵, mungesa e arsytimit të mjaftueshëm të vendimeve gjyqësore¹⁶, e drejta e aksesit në gjykatë¹⁷, e drejta për një seancë dëgjimore,¹⁸ mungesa e plotë e drejtësisë së procedurës (denial of fear hearing)¹⁹. Nga ana tjetër, prezumimi i pafajësisë²⁰, barazia e armëve dhe e drejta e mbrojtjes në lidhje me pranueshmërinë e deklaratave të dëshmitarëve në mungesë ose me identitet të fshehur dëshmitarë (të rrezikuar)²¹ dhe prania e të akuzuarit në seancë²², vlerësimin e gjetjeve dhe opinioneve të ekspertëve²³, e drejta për një seancë dëgjimore²⁴, pranueshmëria e provave të marra në mënyrë të paligjshme²⁵, përdorimi i një agjenti provokator²⁶ dhe të drejtën e një interpretuesi²⁷, papranueshmëria e dëshmi²⁸ janë trajtuar në shumë lëndë penale në GJEDNJ, duke përfshirë edhe rastet e kundërvajtjes.

Shkelje është konstatuar në 14 aktgjykime referuar nenit 1 të Protokollit nr. 1, që e garanton atë *e drejta e pronësisë*, për shkak të anulimit të një vendimi të formës së prerë që i njehtë drejtën për pension²⁹, refuzimi për kthimin në pronësi të truallit të konfiskuar në procedurë denacionalizimi, edhe pse ishin plotësuar kushtet ligjore³⁰, kompensimi i pamjaftueshëm për shpronësimin e tokës së aplikantëve në favor të një personi juridik³¹, konfiskimi i automjeteve

¹³ *Stojmenović dhe Milloshević*, aktgjykimi i datës 25 mars 2021, *Mitrov*, aktgjykimi i datës 2 qershor 2016; *Mitrinovski*, aktgjykimi i datës 30 prill 2015; *Bajalxhiev*, aktgjykimi i datës 25 tetor 2011; *Nikolov*, aktgjykimi i datës 20 dhjetor 2007.

¹⁴ *Bajiq*, aktgjykimi i datës 10 qershor 2021, *Taseva-Petrovska*, aktgjykimi i datës 11 janar 2018; *Naumoski*, aktgjykimi i datës 27 nëntor 2012; *Grozdanoski*, aktgjykimi i 31 majit 2007.

¹⁵ *Kërstanoski dhe të tjerët*, aktgjykimi i datës 7 dhjetor 2017; *Stoilkovska*, aktgjykimi i datës 18 korrik 2013.

¹⁶ *Bileski*, aktgjykimi i datës 6 qershor 2019; *Atanasovski*, aktgjykimi i datës 14 janar 2010; *ASP PP SHPKNJ*, aktgjykimi i datës 6 qershor 2019.

¹⁷ *Prodanov*, aktgjykimi i datës 10 qershor 2021, *Adilovska*, aktgjykimi i datës 23 janar 2020; *Qendra për Zhvillimin e Psikologjisë Analitike*, aktgjykimi i datës 15 qershor 2017; *Balazhoski*, aktgjykimi i datës 25 prill 2013; *Spasovski*, aktgjykimi i datës 10 qershor 2010; *Demexhiev dhe të tjerët*, aktgjykimi i datës 10 qershor 2010; *Boris Stojanovski*, aktgjykimi i datës 6 maj 2010; *Petkoski dhe të tjerët*, aktgjykimi i datës 8 janar 2008; *Fetaovski*, aktgjykimi i datës 19 qershor 2008. Një shkelje në këtë kuptim nuk u konstatua në *Ivanovski*, aktgjykimi i datës 21 janar 2016.

¹⁸ *Bileski*, aktgjykimi i datës 6 qershor 2019; *Selmani dhe të tjerët*, aktgjykimi i datës 9 shkurt 2017; *Mitkova*, aktgjykimi i datës 15 tetor 2015.

¹⁹ *Talevska dhe Tërçeska*, aktgjykimi i datës 28.06.2022

²⁰ *Milaçiq*, aktgjykimi i datës 14 tetor 2021 (në të cilin nuk u konstatuan shkelje në këtë drejtim), *Ramkovski*, aktgjykimi i datës 8 shkurt 2018; *Poletan dhe Aziroviq*, aktgjykimi i datës 12 maj 2016; *Miladinov dhe të tjerët*, aktgjykimi i datës 24 prill 2014.

²¹ *Boshkoski*, aktgjykimi i datës 4 qershor 2020; *Ziberdhe*, aktgjykimi i datës 6 qershor 2019; *Asani*, aktgjykimi i datës 1 shkurt 2018; *Donçev dhe Burgov*, aktgjykimi i datës 12 qershor 2014; *Iljazi*, aktgjykimi i datës 3 tetor 2013; *Papadakis*, aktgjykimi i datës 26 shkurt 2013; *Trampevski*, aktgjykimi i datës 10 korrik 2012; *Atanasov (nr. 2)*, aktgjykimi i datës 19 prill 2011; *Solakov*, aktgjykimi i 31 tetorit 2001.

²² *Eftimov*, aktgjykimi i datës 2 korrik 2015; *Atanasov*, aktgjykimi i datës 17 shkurt 2011; *Nasteska*, aktgjykimi i datës 27 maj 2010; *Mitrevski*, aktgjykimi i 21 qershorit 2006.

²³ *Dushko Ivanovski*, aktgjykimi i datës 24 prill 2014; *Stoimenov*, aktgjykimi i 5 prillit 2007.

²⁴ *Kostovski*, Aktgjykimi i datës 07.06.2022, *TRANSKOP SHA Manastir*, aktgjykimi i 1 prillit 2021.

²⁵ *Hajrullahu*, aktgjykimi i datës 29 tetor 2015.

²⁶ *Gjorgievski*, aktgjykimi i 16 korrikut 2009.

²⁷ Shkelje nuk u konstatua në *Sandel*, aktgjykimi i 27 majit 2010.

²⁸ *Kostovski*, aktgjykimi i datës 07.06.2022.

²⁹ *Romeva*, aktgjykimi i datës 12 dhjetor 2019.

³⁰ *Stojanovski dhe të tjerët*, aktgjykimi i datës 23 tetor 2014 dhe aktgjykimi i datës 7 shkurt 2019 lidhur me dëmin material në rastin konkret.

³¹ *Arsovski*, aktgjykimi i datës 15 janar 2013 dhe aktgjykimi i datës 7 shkurt 2019 lidhur me dëmin material në rastin konkret.

që janë përdorur si mjet për kryerjen e një vepre penale ose kundërvajtjeje³² dhe moslejimi i zbritjes së TVSH-së nga kompania aplikuese³³. Në rastin e përdoruesve të përjashtuar të energjisë termike në objektet e banimit kolektiv, të cilët ishin të detyruar t'i paguanin një shumë të madhe furnizuesit, Gjykata gjithashtu konstatoi se shteti kishte kryer shkelje të së drejtës së pronës.³⁴ Anulimi i jashtëzakonshëm i një vendimi të formës së prerë dhe të detyrueshëm për denacionalizim, i cili kishte për qëllim korrigjimin e “lëshimeve të dukshme” të autoriteteve administrative, nuk përbënte shkelje.³⁵

Gjykata ka marrë 4 aktgjykime për nenin 2, *e drejta për jetë*³⁶, duke vërtetuar një shkelje edhe aty ku nuk kishte vdekje, por aplikuesit i është shkaktuar lëndim nga një oficer policie³⁷. Nuk u konstatua shkelje në rastin e veprimeve ose mosveprimeve të personave të përfshirë në mosdenoncim të veprës penale, që rezultoi me vdekjen e djalit të aplikantit, i cili u vra nga një pjesëtar i forcave speciale të policisë.³⁸ Shtyrja prej 18 muajsh e ekzekutimit të dënimit me burg të shkelësit u konsiderua pjesë përbërëse e detyrimit procedural të shtetit sipas nenit 2.³⁹

Në 14 nga 15 aktgjykime sipas nenit 3, *ndalimi i torturës*, Gjykata konstatoi shkelje në pjesën procedurale⁴⁰. Në shumë lëndë, Gjykata theksoi se viktimave me lëndime të supozuara nuk u kërkohet të fillojnë ndjekjen penale të vetë zyrtarëve të autorizuar të shtetit, por është detyrë e prokurorit të shqyrtojë aplikantin dhe të marrë parasysh të gjitha provat, d.m.th. hetim efektiv⁴¹, dhe në një lëndë Gjykata e konsideroi si formalizëm të tepruar këmbënguljen e aplikuesit për të zbuluar identitetin e të gjithë punonjësve të policisë kundër të cilëve ai bëri kallëzim penal.⁴² Përveç në *El-Masri* dhe në rastin *Hajrullahu*, Gjykata e cilësoi trajtimin si torturë, duke konsideruar se aplikanti ishte kërcënuar për të marrë një rrëfim, gjë që i shkaktoi

³² *Anev dhe Najdovski*, aktgjykimi i datës 3 shtator 2020; *Jakimovski dhe Karri transport*, aktgjykimi i datës 14 nëntor 2019; *Anastasov*, aktgjykimi i datës 26 shtator 2019; *Vasilevski*, aktgjykimi i datës 28 prill 2016; *Andonoski*, aktgjykimi i datës 17 shtator 2015. Nuk u konstatua asnjë shkelje te *Sulejmani*, aktgjykimi i datës 28 prill 2016.

³³ *Auto Atom Sh.p.k.Koçani*, aktgjykimi i 28 majit 2020.

³⁴ *Strezovski*, aktgjykimi i datës 27 shkurt 2020.

³⁵ *Spiridonovska dhe Popovski*, aktgjykimi i datës 19 tetor 2017; *Toleski*, aktgjykimi i datës 15 qershor 2017; *Vikentijeviq*, aktgjykimi i datës 6 shkurt 2014.

³⁶ *Kitanovska-Stanojkoviq dhe të tjerë*, aktgjykimi i datës 13 tetor 2016; *Neskoska*, aktgjykimi i datës 21 janar 2016; *Kitanovski*, aktgjykimi i datës 22 janar 2015; *Sasho Gjorgiev*, aktgjykimi i datës 19 prill 2012.

³⁷ *Sasho Gjorgiev*, aktgjykimi i datës 19 prill 2012.

³⁸ *Neskoska*, aktgjykimi i datës 21 janar 2016.

³⁹ *Kitanovska-Stanojkoviq dhe të tjerë*, aktgjykimi i datës 13 tetor 2016.

⁴⁰ *Trendafilovski*, aktgjykimi i datës 17 dhjetor 2020; *X dhe Y*, aktgjykimi i 5 nëntorit 2020, *Selami dhe të tjerë*, aktgjykimi i datës 1 mars 2018; *Aslani*, aktgjykimi i datës 10 dhjetor 2015; *Hajrullahu*, aktgjykimi i datës 29 tetor 2015; *Andonoski*, aktgjykimi i datës 23 korrik 2015; *Kitanovski*, aktgjykimi i datës 22 janar 2015; *El-Masri*, aktgjykimi i Këshillit të Madh Gjyqësor i datës 13 dhjetor 2012; *Gjorgiev*, aktgjykimi i datës 19 prill 2012; *Sulejmanov*, aktgjykimi i datës 24 prill 2008; *Xheladinov dhe të tjerë*, aktgjykimi i datës 10 prill 2008; *Trajkoski*, aktgjykimi i datës 7 shkurt 2008; *Jashar*, aktgjykimi i 15 shkurtit 2007.

⁴¹ *Trendafilovski*, aktgjykimi i datës 17 dhjetor 2020; *X dhe Y*, aktgjykimi i 5 nëntorit 2020.

⁴² *Trajkoski*, aktgjykimi i 7 shkurtit 2008.

dhimbe dhe vuajtje emocionale, psikologjike dhe fizike.⁴³ Në shumë lëndë, Gjykata theksoi se viktimave të lëndimeve të supozuara nuk u kërkohet të iniciojnë ndjekje penale kundër zyrtarëve të autorizuar shtetëror, por kjo është detyrë e prokurorit. Vënia në pranga e aplikantes së sëmure mendore gjatë transportit të saj në spital përbente trajtim degradues në kundërshtim me një aspekt thelbësor të nenit 3.⁴⁴ Gjykata konstatoi shkelje të aspektit material të nenit 3 të Konventës dhe trajtim degradues në rastin e kujdesit joadekuat të një fëmije tetë vjeçar të sëmure mendor, i cili ishte vendosur në një institucion të papërshtatshëm për gjendjen e tij shëndetësore për më shumë se një vit dhe nëntë muaj⁴⁵, dhe në lidhje me të njëjtin rast ka konstatuar shkelje për shkak të mungesës së një hetimi efikas, si detyrim ndërkombëtar i shtetit.

Në lidhje me ndalimin e *garantuar të diskriminimit* sipas Konventës, në një rast, Gjykata përcaktoi shkelje të nenit 14 në lidhje të nenit 3 shkak i suksesit të autoriteteve vendore ti hetojnë gjetjet e aplikantit për brutalitet policor të motivuar racor⁴⁶, dhe në rastin kur Gjykatat vërtetoi shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 2 të Protokollit numër 1, të KEDNJ, shkak i se nuk ka qenë i parandaluar segregacioni i fëmijëve rom në dy shkolla fillore shtetërore në Manastir dhe Shtip⁴⁷.

Shkeljet ishin konstatuar në të 10 aktgjykimet e miratuara për nenin 5, *e drejta për liri dhe siguri*⁴⁸. Aktgjykimi i Këshillit të Madh në *El-Masri kundër Maqedonisë*⁴⁹ kishte të bënte me arrestimin arbitrar *incommunicado* të shtetasit gjerman, "dorëzimin e tij të jashtëzakonshëm" dhe transferimin e tij në Afganistan, ku ai u keqtrajtua. Përveç kohëzgjatjes së tepërt të paraburgimeve dhe paarsyeshmërisë së aktvendimeve kolektive të paraburgimit⁵⁰, GJEDNJ-ja e diskutoi edhe të drejtën e të akuzuarit për të marrë pjesë në mënyrë efektive në procedurën në të cilën arresti shtëpiak i tij inicial ishte zëvendësuar me paraburgim⁵¹, mungesa e dyshimit të arsyeshëm se aplikanti ka kryer vepër penale⁵², burgosja e paligjshme për shkak të pretendimit të moszbatimit të urdhrin të gjykatës për të paguar gjobën dhe mosinformimit të aplikantit për arsyet e burgosjes së tij⁵³, mosdhënia e kompensimit (të mjaftueshëm) për shkak të privimit të paligjshëm nga liria (dhe torturës së

⁴³ *Hajrullahu*, aktgjykimi i datës 29 tetor 2015.

⁴⁴ *Ilievska*, aktgjykimi i datës 7 maj 2015.

⁴⁵ *L.R.*, aktgjykimi i datës 23 janar 2020.

⁴⁶ *Memedov*, aktgjykimi i datës 24 qershor 2021.

⁴⁷ *Elmazova dhe të tjerët*, aktgjykimi i datës 13.12.2022.

⁴⁸ *Sejdiji*, aktgjykimi nga 7 qershor 2018; *Selami dhe të tjerët*, aktgjykimi nga 1 mars 2018; *Ramkovski*, aktgjykimi nga 8 shkurt 2018; *Milladinov dhe të tjerët*, aktgjykimi nga 24 prill 2014; *Velinov*, aktgjykimi nga 19 shtator 2013; *El-Masri*, aktgjykimi i Këshillit të Madh Gjyqësor nga 13 dhjetor 2012; *Vasillkoski dhe të tjerët*, aktgjykimi nga 28 tetor 2010; *Mitreski*, aktgjykimi nga 25 mars 2010; *Trajçe Stojanovski*, aktgjykimi nga 22 tetor 2009; *Llazoroski*, aktgjykimi nga 8 tetor 2009.

⁴⁹ *El-Masri*, aktgjykimi i Këshillit të Madh Gjyqësor nga 13 dhjetor 2012.

⁵⁰ *Sejdiji*, aktgjykimi nga 7 qershor 2018; *Ramkovski*, aktgjykimi nga 8 shkurt 2018; *Milladinov dhe të tjerët*, aktgjykimi nga 24 prill 2014; *Vasillkoski dhe të tjerët*, aktgjykimi nga 28 tetor 2010.

⁵¹ *Mitreski*, aktgjykimi nga 25 mars 2010.

⁵² *Llazoroski*, aktgjykimi nga 8 tetor 2009.

⁵³ *Velinov*, aktgjykimi nga 19 shtator 2013.

aplikantit gjatë privimit nga liria)⁵⁴, si dhe vazhdimi i paarsyeshëm i ndalimit në institucionin psikiatrik⁵⁵.

Shkelja ishte konstatuar në 10 nga 11 aktgjykimet për nenin 8, *e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare*, që përfshinte refuzimin e ndryshimit të përkatësisë etnike në Listën Zgjedhore Gjyqësore gjatë shpalljes⁵⁶, refuzimin e kërkesës së personit transgjinator për të ndryshuar gjininë në evidencën e amzës⁵⁷, të drejtën e respektimit të reputacionit⁵⁸, moszbatimin e aktvendimeve për ruajtjen e kontakteve midis prindërve dhe fëmijëve të tyre⁵⁹, integritetin moral dhe fizik të personit⁶⁰, ruajtjen e pacaktuar kohore të mostrave të ADN-së të personave të dënuar dhe mungesën e mundësisë për të kërkuar fshirjen e tyre⁶¹ dhe grumbullimin e të dhënave mjekësore konfidenciale të ankuesve nga policia pa masa të mjaftueshme mbrojtëse për zbulimin e tyre⁶².

Në gjithsej 4 aktgjykime kundër shtetit ishte konstatuar shkelja e nenit 10 të Konventës, që e garanton *të drejtën e lirisë së shprehjes*— për shkak të largimit me forcë të gazetarëve nga galeria parlamentare teksa raportonin për debatin për miratimin e buxhetit të shtetit për vitin 2013⁶³; në një rast në të cilin ishte konstatuar përgjegjësia penale e aplikantit për shpifje, Gjykata konstatoi se dënimi i tillë kishte efekt dekurajues lidhur me debatin politik si bazë për funksionimin e demokracisë⁶⁴; Gjykata konstatoi shkelje edhe në rastin e kolumnistit i cili ishte dënuar penalisht për shpifje për kritikimin e gazetarit në kolumnën e tij⁶⁵; në një rast kundër shtetit, Gjykata konstatoi shkelje të lirisë së shprehjes sepse vendimi i gjykatës civile për kompensimin e dëmit kundër aplikantëve, të cilët si gazetarë përcillnin dhe citonin informacion për funksionarin publik në atë kohë, ende vepronin me kujdesin e nevojshëm që kërkohet nga gazetaria përgjegjëse duke raportuar për çështjen me interes publik dhe nuk mund të konsiderohen përgjegjës për shkak të pamundësisë për të përcaktuar vërtetësinë e konstatimeve të kontestueshme, si dhe për shkak se lartësia e

⁵⁴ *Selami dhe të tjerët*, aktgjykimi nga 1 mars 2018; *Velinov*, aktgjykimi nga 19 shtator 2013.

⁵⁵ *Trajçe Stojanovski*, aktgjykimi nga 22 tetor 2009.

⁵⁶ *Tasev*, aktgjykimi nga 16 maj 2019.

⁵⁷ *H*, aktgjykimi nga 17 janar 2019.

⁵⁸ *Karajanov*, aktgjykimi nga 6 prill 2017; *Ivanovski*, aktgjykimi nga 21 janar 2016; *Popovski*, aktgjykimi nga 31 tetor 2013.

⁵⁹ *Oluri*, aktgjykimi nga 16 janar 2020, *Mitovi*, aktgjykimi nga 16 prill 2015. Në të kundërtën, shkelja në këtë aspekt nuk ishte konstatuar në *Mitrova dhe Saviq*, aktgjykimi nga 11 shkurt 2016.

⁶⁰ *El-Masri*, aktgjykimi i Këshillit të Madh Gjyqësor nga 13 dhjetor 2012.

⁶¹ *Trajkovski dhe Çipovski*, aktgjykimi nga 13 shkurt 2020.

⁶² *J.M. dhe A.T.*, aktgjykimi nga 22 tetor 2020.

⁶³ *Selami dhe të tjerët*, aktgjykimi nga 9 shkurt 2017.


⁶⁴ *Makraduli*, aktgjykimi nga 19.07.2018.

⁶⁵ *Gelevski*, aktgjykimi nga 8 tetor 2020.

shumave të dhëna për kompensimin e dëmit kishte efekt dekurajues lidhur me diskutimin e hapur të temave me rëndësi publike⁶⁶.

Vetëm një rast sipas nenit 11 sipas të cilit garantohej *liria e tubimit dhe e shoqërimit* i referohet ndërprerjes së shoqërisë civile⁶⁷, ndërsa 4 raste kishin të bënin me ndalimin e regjistrimit të bashkësive fetare (shkelja e nenit 11 në lidhje me nenin 9)⁶⁸.

5. AKTGJYKIMET DHE VENDIMET E GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË LËNDËT KUNDËR REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT GJATË VITIT 2022



5.1. Aktgjykimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lëndët kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë vitit 2022

Nga 6 aktgjykimet kundër shtetit të miratuara në vitin 2022, 3 aktgjykime ishin miratuar nga këshilli prej shtatë gjykatësve⁶⁹, ndërsa 3 nga komiteti prej tre gjykatësve⁷⁰. Në 2 raste, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 6⁷¹, në një rast shkelja e nenit 14 në lidhje me nenin 2 të

⁶⁶ *Kostova dhe Apostollov*, aktgjykimi nga 05.04.2022.

⁶⁷ *Shoqata e Qytetarëve "Radko" dhe Paunkovski*, aktgjykimi nga 15 janar 2009.

⁶⁸ *Manastiri i Vjetër "Shën Gjoni Gojarti"*, aktgjykimi nga 29 nëntor 2018; *"Kisha e të krishterëve të vërtetë ortodoksë" dhe Ivanovski*, aktgjykimi nga 29 nëntor 2018; *"Komuniteti Bektashian" dhe të tjerët*, aktgjykimi nga 12 prill 2018; *"Kryepeshkopata Ortodokse e Ohrit (Kryepeshkopata Ortodokse Greke e Patriarkanës së Pejës)"*, aktgjykimi nga 16 nëntor 2017.

⁶⁹ *Mickovski*, aktgjykimi nga 24 mars 2022; *A.A. dhe të tjerët*, aktgjykimi nga 5 prill 2022; *Elmazova dhe të tjerët*, aktgjykimi nga 13 dhjetor 2022.

⁷⁰ *Kostova dhe Apostollov*, aktgjykimi nga 5 prill 2022; *Kostovski*, aktgjykimi nga 7 qershor 2022; *Talevska dhe Tërçeska*, aktgjykimi nga 28 qershor 2022.

⁷¹ *Kostovski*, aktgjykimi nga 7 qershor 2022; *Talevska dhe Tërçeska*, aktgjykimi nga 28 qershor 2022.

Protokollit nr. 1 të Konventës⁷², në një rast shkelja e nenit 10 të KEDNJ-së⁷³, ndërsa në 2 raste Gjykata ka konstatuar se shteti nuk ka bërë shkelje (në një rast ka konstatuar se nuk ka pasur shkelje të së drejtës së pronësisë në përputhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së⁷⁴, ndërsa në një rast Gjykata konstatoi se shteti nuk ka bërë shkelje të nenit 4 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së, as shkelje të nenit 13 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 4 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së⁷⁵).

Gjatë vitit 2022, GJEDNJ-ja i miratoi aktgjykimet e mëposhtme kundër shtetit:

Aplikimet në rastin *Mickovski*⁷⁶ u referohen konstatimeve ankimore për shkeljen e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, sepse pezullimi i përkohshëm i pozicionit të tij ekzekutiv (për shkak të hetimit penal të iniciuar kundër aplikantit) dhe vendimi gjyqësor pasues me të cilin kërkesa e padisë së aplikantit për kompensimin e dëmit që aplikanti pretendohet se ka pësuar gjatë pezullimit ishte refuzuar, kontribuan për shkeljen e së drejtës së tij të pronësisë. GJEDNJ-ja me aktgjykimin konkludoi se në këtë rast nuk kishte shkelje të së drejtës së pronësisë së aplikantit kryesisht për shkak të lëshimit të aplikantit për të treguar se për shkak të pezullimit të përkohshëm ai pësoi barrë të tepërt individuale.

Konstatimet ankimore të aplikantëve në rastin *A.A. dhe të tjerët*⁷⁷ iu referuan faktit se ata ishin deportuar nga shteti i paditur pa u identifikuar individualisht, përkatësisht se dëbimi i tyre ishte i natyrës kolektive, si dhe se nuk kishin mundësi për mjetin juridik efektiv në lidhje me dëbimin e tyre nga shteti. Në aktgjykimin e saj, gjykata konstatoi se sipas legjislacionit vendas, aplikantët kishin mundësinë të hynin në territorin e shtetit të paditur në pikat kufitare që ishin të përcaktuara ligjërisht si të ligjshme për hyrjen e shtetasve të huaj nëse i përmbushnin kriteret e hyrjes ose, nëse kanë kërkuar azil ose nëse të paktën kanë deklaruar se kanë ndërmend të parashtrojnë kërkesë për azil. Në këtë mënyrë do të shqyrtoheshin rrethanat individuale të secilit azilkërkues. Megjithatë, në këtë rast, aplikantët kanë kaluar ilegalisht kufirin e shtetit të paditur, duke e anashkaluar procedurën efektive për hyrje të ligjshme. Gjykata konstatoi se nuk kishte shkelje të nenit 4 të Protokollit nr. 4 të KEDNJ-së, që

⁷² *Elmazova dhe të tjerët*, aktgjykimi nga 13 dhjetor 2022.

⁷³ *Kostova dhe Apostollov*, aktgjykimi nga 5 prill 2022.

⁷⁴ *Kostovski*, aktgjykimi nga 7 qershor 2022.

⁷⁵ *A.A. dhe të tjerët*, aktgjykimi nga 5 prill 2022.

⁷⁶ *Mickovski*, aktgjykimi nga 24 mars 2022.

⁷⁷ *A.A. dhe të tjerët*, aktgjykimi nga 5 prill 2022.

është ndalimi i dëbimit kolektiv të të huajve, as shkelje të nenit 13 të KEDNJ-së (që e garanton të drejtën për mjetin juridik efektiv) në lidhje me nenin 4 të Protokollit nr. 4 nga KEDNJ-ja.

Aplikimi *Kostova dhe Apostollov*⁷⁸ iu referua konstatimeve ankimore se vendimet e gjykatave vendase kundër aplikantëve përbënin ndërhyrje të pajustificuar në ushtrimin e së drejtës së tyre për lirinë e shprehjes, të garantuar në nenin 10 të Konventës. Më konkretisht, në rastin bëhet fjalë për dy tekste që aplikantët i kishin botuar në gazetën javore, në të cilat citonin ose referonin deklaratat që u ishin dorëzuar nga z. I., që funksionari i atëhershëm publik z. S. ka ushtruar presion mbi bartësit e tjerë të funksioneve publike me qëllim që të ndikojë në punët personale të z. I., në periudhën kur vet I. ishte bartës i funksionit publik, si dhe se z. S. posedonte "perandori biznesi në Çeki". Pasi funksionari publik S. inicioi procedurë civile për shpifje kundër aplikantëve, gjykatat vendase në dy instanca në procedurën civile konstatuan se aplikantët kishin dëmtuar reputacionin e tij duke publikuar fakte të pavërteta të cilat i përshkruanin si "thashetheme", pa u përpjekur më parë të konfirmonin besueshmërinë e tyre dhe se informacionet e publikuara nuk ishin me interes publik, por kishin hyrë në jetën e tij private. Më pas, edhe Gjykata Kushtetuese i konfirmoi qëndrimet e tilla të gjykatave të rregullta. Gjykata konstatoi se aplikantët kishin vepruar me kujdes që pritej nga gazetarët përgjegjës që raportnin për çështjet me interes publik; përmbajtja e tekstit nuk ishte shpikur prej tyre, por theksohej qartë se informacioni ishte marrë nga burimi anonim; lartësia e shumave për kompensim për dëmin e pretenduar të shqiptuar nga gjykatat civile kishte "efektin e përgjigjes" që e dekurajon diskutimin e hapur të temave me interes publik në të ardhmen; gjykatat vendase me vendimmarrjen e tyre nuk kishin ofruar marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit me shkeljen e pretenduar të reputacionit të z. S. Duke pasur parasysh të lartpërmendurën, GJEDNJ-ja konstatoi shkelje të nenit 10 të Konventës.

Në rastin *Kostovski*⁷⁹ aplikanti u ankua se në procedurën vendase të kundërvajtjes kundër tij nuk ishte mbajtur diskutimi me gojë dhe se organet vendase refuzuan të pranonin dëshmi, gjë që ishte në kundërshtim me të drejtat e garantuara në përputhje me nenin 6 paragrafi 1 të Konventës. Gjithashtu, aplikanti u ankua se masat e shqiptuara në procedurën e kundërvajtjes ishin të tepruara dhe, për rrjedhojë, i ishin shkelur të drejtat e garantuara në përputhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. GJEDNJ-ja konstatoi shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë në lidhje me nenin 6 paragrafi 1 të Konventës për faktin se gjykatat vendase e refuzuan

⁷⁸*Kostova dhe Apostollov*, aktgjykimi nga 5 prill 2022.

⁷⁹*Kostovski*, aktgjykimi nga 7 qershor 2022.

kërkesën e aplikantit për diskutimin me gojë dhe nuk i arsyetuan shkaqet për të, si dhe për faktin se nuk i lejuan dëshmitë e propozuara nga aplikanti. Në të njëjtën kohë, GJEDNJ-ja konstatoi se nuk ka nevojë t'i shqyrtojë veçmas konstatimet për shkeljen e së drejtës së pronësisë.

Pas negociatave të pasuksesshme për zgjidhjen miqësore në rastin *Talevska dhe Tërçeska*⁸⁰, Qeveria dorëzoi deklaratë të njëanshme duke pranuar se kishte shkelje të nenit 6 paragrafi 1 dhe shkelje të së drejtës së pronësisë sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës. Megjithatë, Gjykata vendosi të vazhdojë shqyrtimin e aplikimit pas kundërshtimit të aplikantëve se sipas legjislacionit vendas dhe praktikës gjyqësore vendase, deklarata e njëanshme e Qeverisë, në dallim nga aktgjykimi i miratuar i Gjykatës me të cilin konstatohet shkelja, nuk mund të shërbejë si bazë për përsëritjen e procedurës. Në këtë rast, konstatimet ankimore të aplikantëve i referoheshin shkeljes së të drejtës për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 6 paragrafi 1 dhe shkeljes së të drejtës së pronësisë sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Pasi ishin punësuar në Gjykatën Themelore dhe ishin paraqitur në Agjencinë e Punësimit, u.d kryetari i Gjykatës Themelore ka parashtruar kërkesë për çlajmërimin e tyre dhe fshirjen nga sigurimi social. Pasi aplikantët kishin iniciuar kontest përpara Gjykatës Civile, Gjykata e Apelit e kishte refuzuar kërkesën e tyre ankimore si të pabazuar dhe në vendimin e saj iu referua njoftimit të Këshillit Gjyqësor, sipas të cilit konkludoi se u.d. kryetari i kishte nënshkruar aktvendimet e tyre për punësim përpara se të kryhej procedura për regjistrimin e tij në Regjistrin Qendror. Gjykata e Apelit, njoftimin e kontestueshëm të Këshillit Gjyqësor në të cilin e kishte mbështetur vendimmarrjen e saj, edhe pse ishte në kundërshtim me njoftimin e Këshillit Gjyqësor të dorëzuar më herët në procedurë, nuk e kishte dorëzuar tek aplikantët, ndërsa Gjykata Supreme pas kërkesës për revizion nuk ishte prononcuar për konstatimet e aplikantëve lidhur me njoftimin e padorëzuar. Gjykata konstatoi shkelje të garancive të parashikuara në nenin 6 paragrafi 1 të Konventës për shkak se aplikantëve nuk u ishte dorëzuar njoftimi nga Këshilli Gjyqësor i cili ishte vendimtar për vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit, me çka nuk ishte respektuar e drejta për procedurë të drejtë.

⁸⁰ *Talevska dhe Tërçeska*, aktgjykimi nga 28 qershor 2022.

Në rastin *Elmazova dhe të tjerët*⁸¹, Gjykata konstatoi diskriminim, përkatësisht shkelje të nenit 14 dhe nenit 2 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Rasti u referohet konstatimeve ankimore të parashtruara nga aplikantët lidhur me faktin se në dy shkolla fillore shtetërore në Manastir dhe Shtip ishte bërë segregacioni i nxënësve romë. Sipas konkluzionit të Gjykatës në aktgjykim, edhe në mungesë të ndonjë qëllimi diskriminues nga ana e shtetit, Gjykata konsideron se segregacioni i fëmijëve romë në të dy shkollat fillore shtetërore gjatë periudhës së shqyrtuar nuk mund të konsiderohet objektivisht dhe në mënyrë të arsyeshme me qëllimin legjitim. Aktgjykimi i GJEDNJ-së konstatoi shkelje të ndalimit të diskriminimit në lidhje me të drejtën për arsimim, pasi paraprakisht, pavarësisht nga sugjerimet e Avokatit të Popullit, Gjykata Kushtetuese nuk konstatoi shkelje të lirive dhe të drejtave, dhe pasi, në lidhje me të dy shkollat fillore ndërkohë që zgjaste procedura përpara GJEDNJ-së, Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatoi segregacion.

5.2. Vendimet e GJEDNJ-së në lëndët kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë vitit 2022

Gjatë vitit 2022, GJEDNJ-ja miratoi gjithsej 15 vendime kundër Maqedonisë së Veriut.

Në 6 raste, aplikimet i referoheshin së drejtës për gjykim të drejtë në përputhje me 6 të Konventës, 5 raste e adresuan të drejtën e pronësisë së garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1, 2 raste kishin të bënin me të drejtën për liri dhe siguri në përputhje me nenin 5 të KEDNJ-së, 1 rast i referohej ndalimit të përgjithshëm të diskriminimit të garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 12, ndërsa konstatimet ankimore në 1 rast u referoheshin garancive të parashikuara në nenin 8 të Konventës.

Nga 15 vendimet, në 2 vendime për 2 aplikimet e parashtruara kundër shtetit, Gjykata në mënyrë meritore e shqyrtoi rastin.

Në lëndën *Fine SHPK dhe të tjerët*⁸², aplikantët u ankuan se prishja e objektit së tyre banesor-afarist ishte e paligjshme, nuk arriti qëllim legjitim dhe ishte tepër joproportionale. GJEDNJ-ja me vendim konstatoi se konstatimi ankimor i aplikantëve sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 është i parakohshëm (duke pasur parasysh se në rrjedhë është procedura penale kundër disa të akuzuarve me konstatimet se prishja në fjalë ishte e paligjshme). Duke pasur parasysh këtë, GJEDNJ-ja e hodhi poshtë aplikimin për mosshterjen e mjeteve juridike vendase.

⁸¹*Elmazova dhe të tjerët*, aktgjykimi nga 13.12.2022

⁸²*Fine SHPK dhe të tjerët*, vendimi nga 17.05.2022.

Aplikantët në lëndën *Vangellova dhe të tjerët*⁸³, duke iu referuar të drejtave të garantuara me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, pohonin se në tokat që ishin pronësi e tyre ishte ndërtuar rruga komunale dhe nëpër to kalonin disa kablllo të transmetimit të rrymës, pa u zbatuar më parë asnjë procedurë për shpronësim ose pagesën e kompensimit. Prandaj, aplikantët u ankuan se duhet t'u shqiptohet kompensimi në të holla për heqjen e së drejtës së pronësisë, e cila ishte me interes publik. Duke pasur parasysh të lartpërmendurën, kundërshtimin e Qeverisë për mospërdorimin e mjeteve juridike vendase, Gjykata e pranoi dhe aplikimin e hodhi poshtë në bazë të papranueshmërisë.

Numri i vendimeve të tjera për të cilat vendosi GJEDNJ-ja gjatë vitit 2022 ishte si në vijim: 7 vendime për zgjidhjen e lëndëve me marrëveshje pas arritjes së marrëveshjes miqësore midis shtetit dhe aplikantëve⁸⁴, 4 vendime pas njohjes së njëanshme të shkeljes së KEDNJ-së nga shteti⁸⁵, ndërsa 2 lëndë u hoqën nga lista sipas nenit 37 paragrafi 1 (a) të Konventës, i cili e parashikon këtë mundësi në rrethanat që çojnë në konkluzionin se aplikantët nuk kanë për qëllim të vazhdojnë me procedurën sipas aplikimit të tyre përpara Gjykatës.


6. SHUMA E KOMPENSIMIT TË DREJTË TË SHQIPTUAR NGA GJEDNJ-JA ME AKTGJYKIME DHE VENDIME NË LËNDËT KUNDËR REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Gjatë vitit 2022, shuma e mjeteve të shqiptuara për të gjitha bazat nga GJEDNJ-ja (aktgjykime me shkelje të konstatuar të KEDNJ-së, vendime për zgjidhjen e lëndëve me marrëveshje dhe vendime të miratuara në bazë të deklaratës së njëanshme, përkatësisht njohja e shkeljeve të KEDNJ-së) është gjithsej 116.350 euro dhe paraqet zvogëlim në raport me shumën e mjeteve në të holla të shqiptuara nga GJEDNJ-ja në vitin paraprak. Numër rekord prej 353.408 euro të shumave të shqiptuara nga GJEDNJ-ja në lëndët kundër shtetit kishte në vitin 2013.

⁸³ *Vangellova dhe të tjerët*, vendimi nga 17.05.2022.

⁸⁴ *Josifovski*, vendimi nga 10.11.2022; *B.I.*, vendimi nga 20.10.2022; *Koçovska dhe të tjerët*, vendimi nga 02.06.2022; *Milevska dhe të tjerët*, vendimi nga 02.06.2022; *Todorovski*, vendimi nga 05.05.2022; *Stoleski*, vendimi nga 15.03.2022; *M.D.*, vendimi nga 10.03.2022;

⁸⁵ *Kiprovska Lukiq*, vendimi nga 30.08.2022; *Çali*, vendimi nga 03.02.2022; *Jovanovski*, vendimi nga 03.02.2022; *Milevski*, vendimi nga 20.01.2022.



7. LËNDËT NË EKZEKUTIM NËN MBIKËQYRJEN E KOMITETIT TË MINISTRAVE

Meqë gjatë vitit 2016, vendi arriti rekordin për nga numri i aktgjykimeve dhe vendimeve për të cilat u miratua rezolucioni final nga Komiteti i Ministrave gjatë një viti, duke shënuar kështu fundin e procesit të ekzekutimit të tyre, që para se gjithash i referohet mbylljes së rreth 60 aktgjykimeve që konstatuan shkeljen e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm nga neni 6 i KEDNJ-së, ndërsa në disa prej tyre edhe shkeljen e nenit 13 (e drejta për mjetin juridik vendas efikas) në lidhje me nenin 6 (e drejta për gjykim brenda afatit të arsyeshëm), dhe mbi të gjitha, duke i kapitalizuar përpjekjet që ishin bërë në vitet e mëparshme për përshejtimin e procedurave vendase, uljen e numrit të të ashtuquajturave “lëndët e vjetra”, por mbi të gjitha duket si futja e mjetit juridik vendas përpara Gjykatës Supreme për mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, i cili në vitin 2011 ishte shpallur efikas nga GJEDNJ-ja⁸⁶, numri i lëndëve për të cilat Komiteti i Ministrave e mbylli mbikëqyrjen e ekzekutimit gjatë vitit 2022 ishte 28, në dallim nga viti 2021 kur ky numër ishte 13. Për listën prej 15 aktgjykimeve për të cilat u miratua rezolucioni final nga Komiteti i Ministrave gjatë vitit 2022, shih [Aneksi nr. 2](#). Rezolucionet e tjera finale u referohen vendimeve të GJEDNJ-së të miratuara në bazë të marrëveshjes.

Numri i lëndëve në ekzekutim, ndërsa nën mbikëqyrjen e Komitetit të Ministrave ka shënuar rënie të dukshme në vitin 2022, përkatësisht numri në fund të vitit 2022 ishte 29. Ky është numri më i vogël i lëndëve kundër shtetit nën mbikëqyrjen e ekzekutimit nga

⁸⁶ *Axhi-Spirkoska dhe të tjerët*, vendimi nga 3 nëntor 2011.

Komiteti i Ministrave, shikuar në krahasim me fundin e 10 viteve të fundit. Numri i lëndëve të reja që ishin vënë nën mbikëqyrjen e Komitetit të Ministrave në vitin 2022 ishte 10, në dallim me numrin e vitit 2021 kur ishte 20.

Nga “lëndët e reja” ose lëndët që ishin vënë nën mbikëqyrjen e Komitetit të Ministrave gjatë vitit 2022, 2 janë lëndë kryesore⁸⁷, ndërsa 8 klasifikohen si lëndë përsëritëse⁸⁸.

Gjatë vitit 2022, nga Komiteti i Ministrave u mbyll ekzekutimi i 28 lëndëve, nga të cilat 6 lëndë u klasifikuan si lëndë kryesore.

Gjatë vitit 2022, nga Byroja e Përfaqësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut ishin hartuar dhe në Komitetin e Ministrave ishin dërguar 11 plane veprimi / raporte për gjithsej 20 aktgjykime të GJEDNJ-së përmes të cilave shteti referon, ndërsa Komiteti i Ministrave mbikëqyr ekzekutimin e aktgjykimeve të GJEDNJ-së kundër shtetit. Për listën e këtyre lëndëve shih **Aneksin nr. 3**.

Republika e Maqedonisë së Veriut e përfundoi vitin 2022 me 29 lëndë në ekzekutim nën mbikëqyrjen e Komitetit të Ministrave, prej të cilave 1 lëndë ishte lëndë kryesore. Për listën e lëndëve kryesore në ekzekutim nën mbikëqyrjen e Komitetit të Ministrave, shih më shumë në **Aneksin nr. 4**. Në fund të vitit 2022, nën mbikëqyrjen e përforcuar të Komitetit të Ministrave ishin 3 aktgjykime të GJEDNJ-së të cilat janë lëndë kryesore⁸⁹, dhe 8 lëndë përsëritëse⁹⁰.


⁸⁷ **Lëndët kryesore** për nevojat e mbikëqyrjes së ekzekutimit janë ato lëndë që më së shpeshti identifikohen nga Komiteti i Ministrave (por mund edhe nga GJEDNJ-ja) si lëndë që ekspozojnë probleme strukturore në shtet dhe ekzekutimi i të cilave kërkon detyrimisht marrjen e të ashtuquajturave masa të përgjithshme, të cilat kanë për qëllim parandalimin e shkeljeve të ngjashme të KEDNJ-së në të ardhmen dhe/ose aktgjykimeve që, në varësi të rrethanave, kërkojnë marrjen e masave më komplekse për ekzekutimin e tyre.

⁸⁸ **Lëndët e “klonuara” ose përsëritëse** në parim janë ato që u referohen problemeve strukturore ose të përgjithshme që janë iniciuar tashmë përpara Komitetit të Ministrave në një ose më shumë lëndë kryesore kundër shtetit, kështu që këto lëndë për qëllimet e mbikëqyrjes së ekzekutimit më shpesh grupohen në grup me lëndën kryesore në lidhje me të njëjtin problem.


⁸⁹ *H*, aktgjykimi nga 17 janar 2019; “Kryepeshkopata Ortodokse e Ohrit (Kryepeshkopata Ortodokse Greke e Patriarkanës së Pejës)”, aktgjykimi nga 16 nëntor 2017; *Kitanovski*, A. nr. 15191/12, aktgjykimi nga 22 janar 2015.

⁹⁰ 7 që i përkasin grupit të Kitanovskit dhe 1 që i përket grupit të “Kryepeshkopatës Ortodokse të Ohrit (Kryepeshkopata Ortodokse Greke e Patriarkanës së Pejës)”.


LËNDËT NËN MBIKËQYRJEN E EKZEKUTIMIT NGA KOMITETI I MINISTRAVE



LËNDËT PËR TË CILAT KOMITETI I MINISTRAVE MIRATOI REZOLUCIONE FINALE DHE E MBYLLI MBIKËQYRJEN E EKZEKUTIMIT



RASTET E REJA NËN MBIKËQYRJEN E EKZEKUTIMIT NGA KOMITETI I MINISTRAVE



ANEKSI NR. 1				
LËNDËT KUNDËR REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT TË DORËZUARA PËR PËRGJIGJE NË VITIN 2022				
	LËNDA	NUMRI I APLIKIMIT	APLIKANT / Ë	KONSTATIMET ANKIMORE TË APLIKANTIT / APLIKANTËVE
1.	PESHOV dhe 2 aplikime të tjera	A. nr. 18678/18	Mitko Peshov	neni 5 § 3 i Konventës neni 5 § 4 i Konventës (e drejta për liri dhe siguri)
		A. nr. 27509/18	Sasho Vasilevski	
		A. nr. 19821/20	Spiro Ristovski	
2.	JANAKIEVSKI dhe 1 aplikim tjetër	A. nr. 57325/19, 16291/20	Mile Janakievski	neni 5 §§ 1 (v) neni 5 § 3 neni 5 § 4 i Konventës (e drejta për liri dhe siguri)
3.	TRIFUNOVSKI dhe 1 aplikim tjetër	A. nr. 5074/20, 39826/20	Miroslav Trifunovski dhe Goce Jakshovski	neni 6 § 1 i Konventës (e drejta për gjykim të drejtë)
4.	KUZMANOVSKA DHE TË TJERËT	A. nr. 25967/18	1. Kiraca Kuzmanovska 2. Tatjana Dimkovska 3. Marija Mihajlova 4. Marusha Mihajlova 5. Natasha Mileva 6. Aleksandar Nakov 7. Kiraca Nakova 8. Sulltana Nakova 9. Nikollço Nikollov 10. Trajanka Nikollova 11. Irena Nikollovska	neni 6 § 1 i Konventës (e drejta për gjykim të drejtë) neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës (e drejta e pronësisë)

			12. Mirjana Nikollovska 13. Sonja Petkova 14. Mara Shterievaska 15. Aco Shterjov 16. Miço Shterjov 17. Ica Tashkova	
5.	S.B.	A. nr. 64163/19	S.B. ⁹¹	neni 1 i Protokollit nr. 7 të Konventës (garancitë procedurale në rast të dëbimit të të huajit)
6.	POPOVSKI	A. nr. 51309/21	Oliver Popovski	neni 3 i Konventës (ndalimi i torturës, trajtimit ose dënimit çnjerëzor ose poshtëruës)
7.	MITREVSKA	A. nr. 20949/21	Mirjana Mitrevska	neni 8 i Konventës (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)
8.	B.I.	A. nr. 22849/20	B.I. ⁹²	neni 6 § 1 i Konventës (e drejta për gjykim të drejtë)
9.	VLLAISAVLEVIQ	A. nr. 23215/21	Velimir Vllaisavleviq	neni 8 i Konventës (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)

⁹¹S.B. është pseudonim i përdorur për aplikantët në përputhje me kërkesën e tyre në procedurën përpara GJEDNJ-së për të mbetur anonim. Është e nevojshme të kihet parasysh se në përputhje me rregullat procedurale që e rregullojnë procedurën përpara GJEDNJ-së, të gjitha institucionet shtetërore janë të detyruara të respektojnë detyrimin për ruajtjen e anonimitetit të identitetit personal të aplikantëve.

⁹²B.I. është pseudonim i përdorur për aplikantët në përputhje me kërkesën e tyre në procedurën përpara GJEDNJ-së për të mbetur anonim. Është e nevojshme të kihet parasysh se në përputhje me rregullat procedurale që e rregullojnë procedurën përpara GJEDNJ-së, të gjitha institucionet shtetërore janë të detyruara të respektojnë detyrimin për ruajtjen e anonimitetit të identitetit personal të aplikantëve.

10.	SALIM DHE TË TJERËT	A. nr. 25782/19	Sevdija Salim Ajten Bekir Suvat Bekir Senat Salim	neni 1 i Protokollit nr. 12 të Konventës (ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) dhe/ose neni 14 i KEDNJ-së në lidhje me nenin 2 § 2 të Protokollit nr. 4 të Konventës (ndalimi i diskriminimit në lidhje me lirinë e lëvizjes)
11.	RIPILOSKI	A. nr. 8793/19	Hristijan Ripiloski	neni 4 § 1 i Protokollit nr. 7 të Konventës (e drejta për të mos u gjykuar ose dënuar dy herë)
12.	TRAJÇESKA	A. nr. 13980/19	Katerina Trajçeska	neni 6 § 1 i Konventës (e drejta për gjykim të drejtë)
13.	PETREVSKI	A. nr. 19198/19	Mitko Petrevski	neni 6 § 1 i Konventës (e drejta për gjykim të drejtë)
14.	IVANOVA	A. nr. 15313/19	Vera Ivanova	neni 6 § 1 i Konventës (e drejta për gjykim të drejtë) neni 13 (e drejta për mjetin juridik efektiv) neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës (e drejta e pronësisë)
14.	Y DHE Z	A. nr. 53742/21	Y dhe Z ⁹³	neni 8 i Konventës (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)
15.	NIKOLLOVSKA dhe 1 aplikim tjetër	A. nr. 45935/18 A. nr. 55102/18	Sonja Nikollovska	neni 6 § 1 i Konventës (e drejta për gjykim të drejtë)
16.	ISEINI	A. nr. 35172/22 A. nr. 37064/22 A. nr. 46627/22	Afrim Iseini Bajram Limanov Lupço Llazarevski	neni 6 § 1 i Konventës (kohëzgjatja e procedurës ekzekutive)

⁹³Y dhe Z është pseudonim i përdorur për aplikantët në përputhje me kërkesën e tyre në procedurën përpara GJEDNJ-së për të mbetur anonim. Është e nevojshme të kihet parasysh se në përputhje me rregullat procedurale që e rregullojnë procedurën përpara GJEDNJ-së, të gjitha institucionet shtetërore janë të detyruara të respektojnë detyrimin për ruajtjen e anonimitetit të identitetit personal të aplikantëve.

ANEKSI NR. 2

AKTGJYKIMET KUNDËR REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT, EKZEKUTIMI I TË CILAVE ËSHTË MBYLLUR ME REZOLUCIONET FINALE TË MIRATUARA NGA KOMITETI I MINISTRAVE NË VITIN 2022

	Lënda	Numri i aplikimit	Data e miratimit të aktgjykimit	Data e miratimit të rezolucionit final	Lloji i shkeljes
1.	Kostova dhe Apostollov	A. nr. 38549/16	05.04.2022	14.12.2022	neni 10 i Konventës shkelja e lirisë së shprehjes
2.	Stoimenoviç dhe Millosheviç	A. nr. 59842/14	25.03.2021	20.09.2022	neni 6 § 1 i Konventës procedura e padrejtë për shkak të mungesës së paanërisë
3.	Transkop SHA Manastir	A. nr. 48057/12	01.04.2021	20.04.2022	neni 6 § 1 i Konventës procedura e padrejtë – mosmbajtja e diskutimit me gojë nga gjykatat vendase dhe shkelja e parimit të procedurës kontradiktore
4.	Atanasov (nr. 2) - rasti kryesor	A. nr. 41188/06	19.04.2011	14.12.2022	neni 6 § 1 i Konventës procedura e padrejtë penale – shkelja e së drejtës për të marrë në pyetje dëshmitarët
5.	Janevski – rasti përsëritës në grupin e rasteve Atanasov (nr. 2)	A. nr. 30259/15	19.11.2022	14.12.2022	neni 6 § 1 i Konventës procedura e padrejtë penale – shkelja e së drejtës për të marrë në pyetje dëshmitarët
6.	Boshkoski – rasti përsëritës në grupin e rasteve Atanasov (nr. 2)	A. nr. 71034/13	04.06.2020	14.12.2022	neni 6 § 1 i Konventës procedura e padrejtë penale – shkelja e së drejtës për të marrë në pyetje dëshmitarët
7.	Ziberi – rasti përsëritës në grupin e rasteve Atanasov (nr. 2)	A. nr. 2166/15	06.06.2019	14.12.2022	neni 6 § 1 i Konventës procedura e padrejtë penale – shkelja e së drejtës për të marrë në pyetje dëshmitarët

8.	Smičkovski – rasti përsëritës në grupin e rasteve Atanasov (nr. 2)	A. nr. 15477/14	05.07.2018	14.12.2022	neni 6 § 1 i Konventës procedura e padrejtë penale – shkelja e së drejtës për të marrë në pyetje dëshmitarët
9.	Asani – rasti përsëritës në grupin e rasteve Atanasov (nr. 2)	A. nr. 27962/10	01.02.2018	14.12.2022	neni 6 § 1 i Konventës procedura e padrejtë penale – shkelja e së drejtës për të marrë në pyetje dëshmitarët
10.	Trampevski – rasti përsëritës në grupin e rasteve Atanasov (nr. 2)	A. nr. 4570/07	10.07.2012	14.12.2022	neni 6 § 1 i Konventës procedura e padrejtë penale – shkelja e së drejtës për të marrë në pyetje dëshmitarët
11.	Papadakis – rasti përsëritës në grupin e rasteve Atanasov (nr. 2)	A. nr. 50254/07	26.02.2013	14.12.2022	neni 6 § 1 i Konventës procedura e padrejtë penale – shkelja e së drejtës për të marrë në pyetje dëshmitarët
12.	Dushko Ivanovski – rasti përsëritës në grupin e rasteve Atanasov (nr. 2)	A. nr. 10718/05	24.04.2014	14.12.2022	neni 6 § 1 i Konventës procedura e padrejtë penale – shkelja e së drejtës për të marrë në pyetje dëshmitarët
13.	Iljazi – rasti përsëritës në grupin e rasteve Atanasov (nr. 2)	A. nr. 56539/08	03.10.2013	14.12.2022	neni 6 § 1 i Konventës procedura e padrejtë penale – shkelja e së drejtës për të marrë në pyetje dëshmitarët
14.	Adillovska	A. nr. 42895/14	23.01.2020	06.12.2022	neni 6 § 1 i Konventës shkelja e së drejtës së qasjes në gjykatë
15.	Strezovski dhe të tjerët	A. nr. 14460/16	27.02.2020	14.12.2022	neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës shkelja e së drejtës së pronësisë

Aneksi nr. 3

Lëndët për të cilat janë parashtruar planet e veprimit dhe raportet gjatë vitit 2022:

1. Transkop SHA (A. nr. 48057/12);
2. H (A. nr. 29683/16)
3. Bajiq (A. nr. 2833/13);
4. KOO (A. nr. 3532/07);
5. Stojmenoviq dhe Millosheviq (A. nr. 59842/14);
6. Kostova dhe Apostollov (A. nr. 38549/16);
7. Strezovski dhe të tjerët (A. nr. 14460/16);
8. Adillovska (A. nr. 42895/14);
9. Talevska dhe Tërçeska (A. nr. 11828/16);
10. Kostovski (A. nr. 23773/17);
11. Atanasov nr. 2 (A. nr. 41188/06) – rasti kryesor

Rastet përsëritëse në grupin e rasteve Atanasov nr. 2:

1. Janevski (A. nr. 30259/15)
2. Boshkoski (A. nr. 71034/13)
3. Ziberi (A. nr. 2166/15)
4. Smičkovski (A. nr. 15477/14)
5. Asani (A. nr. 27962/10)
6. Trampevski (A. nr. 4570/07)
7. Papadakis (A. nr. 50254/07)
8. Dushko Ivanovski (A. nr. 10718/05)
9. Iljazi (A. nr. 56539/08).

LËNDËT "KRYESORE" KUNDËR REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT NË EKZEKUTIM NËN MBIKËQYRJEN E KOMITETIT TË MINISTRAVE

	Numri i aplikimit	Data e parashtrimit të aktgjykimit	Data e plotfuqishmërisë	Aplikanti	Lloji i shkeljes	Lloji i mbikëqyrjes
1.	A. nr. 53565/13	16.04.2015	16.07.2015	MITOVI	<p>neni 8 i Konventës shkelja e së drejtës së aplikantëve për respektimin e jetës së tyre familjare, si rezultat i lëshimit të autoriteteve shtetërore për të ndërmarrë përpjekje adekuate dhe efektive për zbatimin e vendimeve të Qendrës për Punë Sociale;</p> <p>neni 13 i Konventës (mungesa e mjetit juridik efektiv) në lidhje me nenin 8 të Konventës;</p>	Mbikëqyrje standarde
2.	A. nr. 15191/12	22.01.2015	22.04.2015	KITANOVSKI	<p>neni 2 i Konventës (aspekti material) përdorimi i trajtimit kërcënues për jetën nga nëpunësit policorë;</p> <p>neni 3 i Konventës (aspekti material) trajtimi degradues nga nëpunësit policorë gjatë burgosjes së tij;</p> <p>neni 2 dhe 3 i Konventës (aspekti hetimor) mungesa e hetimit efektiv për konstatimet ankimore të aplikantit për trajtimin kërcënues dhe degradues për jetën nga nëpunësit policorë;</p>	Mbikëqyrje e përforcuar
3.	A. nr. 28169/08	28.10.2010	28.01.2011	VASILKOSKI DHE TË TJERËT	<p>neni 5§3 i Konventës mungesa e shkaqeve konkrete dhe pamjaftueshëm të arsyetuara për paraburgimin e aplikantëve;</p>	Mbikëqyrje standarde

4.	A. nr. 3532/07	16.11.2017	09.04.2018	"KOO (KRYEPESHKOPATA ORTODOKSE GREKE E PATRIARKANËS SË PEJËS)"	neni 11 në lidhje me nenin 9 të Konventës shkelja e së drejtës së lirisë së shoqërimit për shkak të refuzimit të autoriteteve shtetërore për të regjistruar shoqatën aplikante si subjekt fetar;	Mbikëqyrje e përforcuar
5.	A. nr. 29683/16	17.01.2019	17.04.2019	H	neni 8 i Konventës shkelja e së drejtës së aplikantit për respektimin e së drejtës së privatësisë, si rezultat i kompensimit të kornizës juridike që i rregullon kushtet dhe procedurën e ndryshimit të shenjës së gjinisë në certifikatën e lindjes;	Mbikëqyrje e përforcuar
6.	A. nr. 46082/14	26.09.2019	26.09.2019	ANASTASOV	neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës shkelja e së drejtës së pronësisë për shkak të konfiskimit të automjetit të aplikantit në procedurën e kundërvajtjes që ka parashkruar;	Mbikëqyrje standarde
7.	A. nr. 51599/11	14.11.2019	14.11.2019	JAKIMOVSKI DHE KARI PREVOZ	neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës shkelja e së drejtës së pronësisë së aplikantëve për shkak të konfiskimit të kamionit të tyre gjatë procedurës doganore të kundërvajtjes	Mbikëqyrje standarde
8.	A. nr. 53205/13	13.02.2020	13.06.2020	TRAJKOVSKI DHE ÇIPOVSKI	neni 8 i Konventës shkelja e së drejtës për jetë private për shkak të kornizës juridike në bazë të së cilës organet vendase i morën, përpunuan dhe ruajtën mostrat e tyre të ADN-së;	Mbikëqyrje standarde
9.	A. nr. 73087/12	10.06.2021	10.06.2021	PRODANOV	neni 6 § 1 i Konventës shkelja e së drejtës së aplikantit për qasje në gjykatë për shkak të refuzimit të revizionit të deklaruar nga Gjykata Supreme si e palejuar <i>ratione valoris ratione valoris</i> ;	Mbikëqyrje standarde
10.	A. nr. 2833/13	10.06.2021	10.09.2021	BAJIQ	neni 6 § 1 i Konventës (aspekti penal) mosdorëzimi i përgjigjes me shkrim nga prokurori publik i parashtruar në Gjykatën Supreme të aplikantit nuk korrespondonte me të drejtën për procedurën kontradiktore dhe barazinë e armëve;	Mbikëqyrje standarde

11.	A. nr. 23773/17	07.06.2022	07.06.2022	KOSTOVSKI	neni 6 § 1 i Konventës shkelja e së drejtës së aplikantit për gjykim të drejtë për shkak të dështimit të Drejtorisë së Doganave në vitin 2014 dhe gjykatave administrative në vitin 2016 për të dhënë arsye adekuate për refuzimin e kërkesave të aplikantit për të mbajtur diskutim me gojë dhe për të pranuar si dëshmi video-incizimet e pikës kufitare;	Mbikëqyrje standarde
-----	--------------------	------------	------------	------------------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------